

VENDIM
Nr. 18, datë 26.1.2026

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA.1.” SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/2 prot., datë 21.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Favina.1.’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina.1.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3099 prot., datë 19.12.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 8.1.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 9.1.2026 dhe 10.1.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.1.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 67/1 prot., datë 15.1.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Favina.1.” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Favina.1.” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti